VENDIM
Nr. 7, datë 10.3.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME FUSHË-KRUJË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për alikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik operatorit sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Fushë-Krujë me:

Drejtues ligjor Alfred Cela
Drejtues teknik Rexhep Llega

2. Operatori sh.a. Ujësjellës- Kanalizime Fushë-Krujë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Fushë-Krujë.

4. Kjo licencë është e vlefshme deri në datën 2.4.2017, siç është përcaktuar me vendimin e KKRR-së nr. 18, datë 3.4.2013.

KRYETARI
Avni Dervishi